05/02/2026

Policia e Shtetit

Të reja | Kush jemi | Historiku | Shërbime | Baza ligjore | Vendndodhjet | Video | Programi i transparencës | Kontakt | Denonco Krimin Kibernetik | Drejtoritë Vendore | Policia Kufitare | Policia Rrugore | Donacione | Policimi në Komunitet | Përmbledhja Mujore | Për sinjalizimin | Të Guximshëm pa Armë

Breaking News: Policia Rrugore e Tiranës pajiset me 2 mjete të reja (karrotrec dhe platformë ngritëse)

asp.gov.al
POLICIA E SHTETIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Komunikata

04/02/2026

Raporti I Ngjarjeve, 4 Shkurt 2026

Korçë/Informacion paraprak

Në lagjen nr.4, Korçë, gjatë një konflikti dyshohet se shtetasi P. K., ka dëmtuar në dorë me mjet prerës (thikë) shtetasin B. Q., rreth 37 vjeç, banues në Korçë, i cili aktualisht ndodhet në spitalin e Korçës, jashtë rrezikut për jetën.

Shërbimet e Policisë kanë kapur dhe shoqëruar
në ambientet e komisariatit për veprime të mëtejshme
autorin e dyshuar të ngjarjes, shtetasin P. K.

Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë po punon për dokumentimin ligjor të rastit dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Vlorë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprat penale “Goditja për shkak të detyrës” dhe “Dëmtime të tjera me dashje”, në ngarkim të shtetasit A. H., 33 vjeç, banues në Vlorë.

Më datë 04.02.2026, rreth orës 12:30, në lagjen “Kushtrimi”, Vlorë, ku ishte njoftuar zhvillimi i një proteste nga punonjësit e Ndërmarrjes së Gjelbërimit të Bashkisë Vlorë, dhe ku të pranishëm ishin edhe gazetarë të mediave të ndryshme për pasqyrimin e situatës, shtetasi A. H., dyshohet në gjendje të dehur, ka nisur fillimisht debate verbale dhe më pas fizike me shtetasin G. K., 33 vjeç, me profesion gazetar.

Më pas ka goditur me grushte edhe një 67-vjeçar, duke i shkaktuar dëmtime të lehta.

Shtetasi A. H, u shoqërua në Komisariatin e Policisë Vlorë dhe, pas përfundimit të veprimeve të para hetimore dhe komunikimit me Prokurorin e gatshëm, u procedua penalisht në gjendje të lirë, ndërsa materialet iu referuan

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

DVKM Korçë/Finalizohen në 24 orë, 2 operacione kundër dhënies ndihmë emigrantëve, për të kaluar kufijtë, ilegalisht.

Si rezultat i operacioneve ✅"Rikthimi" dhe ✅"Itinerari", kapen 3 shtetas sudanezë, të cilët të organizuar si grup, ndihmuan 31 emigrantë për të kaluar ilegalisht, kufirin e gjelbër në PKK Kapshticë.

2 shtetasit e kapur gjatë operacionit "Rikthimi", së bashku me 16 emigrantët që kishin ndihmuar, ishin fshehur në një banesë të braktisur në fshatin Qatrom. Banesa u zbulua si rezultat i ndjekjes disaditore, nga shërbimet e Policisë.

Njëri prej të arrestuarve gjatë këtij operacioni, ishte dëbuar më parë nga Republika e Shqipërisë, pasi ishte ndaluar duke kryer të njëjtën veprimtari kriminale.

Si rezultat i hetimeve dhe punës operacionale intensive, të kryera me qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të dhënies ndihmë, kundrejt parave, emigrantëve që synojnë të shkojnë në mënyrë të kundërligjshme, në shtete të BE-së, u finalizuan në 24 orë, operacionet "Rikthimi" dhe "Itinerari".

✅Gjatë operacionit "Rikthimi", u vunë në pranga shtetasit H. A., 27 vjeç dhe M. H., 20 vjeç (i dëbuar më parë, nga Republika e Shqipërisë, pasi u ndalua për të njëjtin krim), sepse si rezultat i ndjekjes disaditore, nga shërbimet e Policisë Kufitare të DVKM Korçë, u kapën në një banesë të braktisur, në fshatin Qatrom, ku ishin fshehur për të shmangur shërbimet e Policisë, së bashku me 16 emigrantët që kishin ndihmuar për të kaluar ilegalisht, kufirin e gjelbër në PKK Kapshticë.

✅Gjatë operacionit "Itinerari", i cili u zhvillua nga Policia Kufitare e DVKM Korçë në bashkëpunim me shërbimet e DVP Korçë, u kap dhe u vu në pranga shtetasi M. H., 30 vjeç, pasi dyshohet se ka ndihmuar 15 emigrantë, për të kaluar ilegalisht, kufirin e gjelbër në PKK Kapshticë. Emigrantët u kapën në territorin e fshatit Drenovë.

Punohet për identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale, të shtetasve të tjerë të përfshirë në këto raste.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Kurbin, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1, vunë në pranga, në Tiranë, shtetasin I. Ll., 48 vjeç, banues në Laç, pasi dyshohet se me automjetin që drejtonte, i ka bllokuar lëvizjen, në aksin rrugor "Laç-Patok", automjetit që drejtonte ish-bashkëshortja e tij, e cila është e pajisur me urdhër mbrojtjeje. Nga kjo, automjetet janë përplasur dhe si pasojë ka patur vetëm dëme materiale. Më pas, 48-vjeçari, dyshohet se ka thyer me mjet të fortë, xhamin e automjetit që drejtonte shtetasja.

Gjithashtu, këto shërbime:
-shpallën në kërkim shtetasin L. B., 51 vjeç, banues në Milot, pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka dhunuar një 26-vjeçar. Punohet për kapjen e shtetasit L. B.;
-referuan materialet në Prokurori, për vlerësim, për shtetasin A. K., 36 vjeç, banues në Tiranë, pasi kanë kallëzuar 2 shtetas, se nuk ka respektuar marrëveshjen ndërmjet tyre, mbi shfrytëzimin e një sipërfaqe toke.

Shërbimet e Policisë Rrugore arrestuan në flagrancë shtetasin A. Gj., 19 vjeç, banues në fshatin Barbullojë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. Gj., 20 vjeç, banues në Lezhë, pasi gjatë kontrollit fizik iu gjet një sasi e vogël lënde e dyshuar narkotike Kokainë, e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin S. P., 61 vjeç, banues në Lezhë, pasi dyshohet se për motive pronësie, ka kanosur një 32-vjeçar. Gjatë kontrollit fizik, të proceduarit iu gjet një mjet prerës (thikë), i cili u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Dje, kallëzoi shtetasi K. I., 65 vjeç, banues në fshatin Shullaz, se i kishin prerë 4 pemë në sipërfaqen e tokës që ka në pronësi në këtë fshat. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve të rastit, dhe për sqarimin e rrethanave.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetaset e huaja, Th. B., A. G. dhe S. M., pasi dyshohet se ushtronin prostitucion, në 2 apartamente të marra me qira.

Specialistët për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, pas komunikimit me Prokurorin e gatshëm, referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal ndaj shtetases O. H., 32 vjeçe, pasi, bazuar në pamjet filmike të shfaqura në emisionin investigativ "Stop", dyshohet se kjo shtetase, nëpërmjet mashtrimit, u ka marrë dy shtetasve një shumë parash prej 35 000 eurosh, me qëllim dërgimin e një të afërmi të tyre për kurim jashtë Shqipërisë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. H., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka qëlluar me shpullë, shtetasin M. K.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-A. Z., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasin Sh. K.;
-I. H., pasi mbante me vete, mjet prerës (thikë), i cili u sekuestrua me cilësinë e provës materiale;
-B. M., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasin A. Sh.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. H., pasi dyshohet se ka ngacmuar me fjalë, një shtetase të mitur;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. M., pasi nuk i është bindur urdhrit të punonjësit të Policisë;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin B. S., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur një shtetas të mitur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-K. P., pasi dyshohet se gjatë punës në subjektin (firmë ndërtimi) që administron, është dëmtuar në dorë, punonjësi në subjekt, shtetasi M. L., 50 vjeç, i cili është jashtë rrezikut për jetën;
-D. I., pasi dyshohet se nëpërmjet thirrjeve/mesazheve telefonike, ka shqetësuar një shtetase.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5:
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. L., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me send të fortë, shtetasin O. T.;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin H. U., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka kanosur shtetasin G. K.;
-shpallën në kërkim shtetasin D. D., pasi dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur shtetasin B. H.. Punohet për kapjen e shtetasit D. D.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6 shpallën në kërkim shtetasin A. Dh., pasi dyshohet se për motive të dobëta, i ka dëmtuar automjetin shtetasit K. Ç.. Punohet për kapjen e shtetasit A. Dh.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë:
-arrestuan shtetasin A. S., 44 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur;
-shpallën në kërkim shtetasin E. M., pasi dyshohet se ka vjedhur në një subjekt, si dhe 1 motomjet. Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për një të mitur që dyshohet se ka bashkëpunuar me shtetasin E. M. Punohet për kapjen e shtetasit E. M., si dhe për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të kenë kryer këta shtetas;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit G. D., B. S. dhe S. B., pasi dje, në fshatin Luz, duke organizuar një protestë të paligjshme, kanë penguar qarkullimin e mjeteve. Punohet për identifikimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale, të shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë rast.

Specialistët e qarkullimit rrugor arrestuan shtetasit:
-A. Xh., 42 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje;
-G. B., 43 vjeç, pasi me automjetin që drejtonte në gjendje të dehur, ka përplasur një automjet. Si pasojë pati vetëm dëme materiale.

Dje, kallëzoi shtetasi A. H., se ishte goditur me grushte, nga 2 shtetas të paidentifikuar prej tij. Punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të rastit, si dhe për sqarimin e rrethanave.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Patos arrestuan shtetasit L. Sh., 32 vjeç, R. Sh., 28 vjeç, dhe M. Sh., 48 vjeç, të tre banues në Patos, pasi dyshohet se kanë goditur me grushte dhe me sende të forta, një 55-vjeçar, për motive të dobëta. 55-vjeçari po merr ndihmë mjekësore në spital dhe aktualisht është jashtë rrezikut për jetën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Divjakë ndaluan shtetasin e shpallur në kërkim E. Ç., 42 vjeç, banues në fshatin Çermë, pasi Gjykata e Fierit e ka dënuar me 6 muaj burgim, për veprën penale "Dhuna në familje".

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin P. D., 52 vjeç, banues në fshatin Frakull e Madhe, pasi nga verifikimet rezultoi se fshihte të ardhurat e përfituara nga veprimtaria në servisin e automjeteve, si dhe iu gjetën në servis, pjesë automjetesh pa dokumentacionin përkatës.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për një 17-vjeçar, pasi është konstatuar duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Specialistët për Hetimin e Krimit të Komisariatit të Policisë Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-F. Y., 66 vjeç, banues në fshatin Varibob, Fier, pasi ka pushtuar një sipërfaqe toke në pronësi të një shtetasi tjetër;

-L. M., 43 vjeçe, banuese në fshatin Levan, Fier, pasi për motive të dobëta, ka goditur me grushte një 25-vjeçare.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Ll., 31 vjeç, pasi ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj të dashurës së tij. Gjithashtu, për këtë rast nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin G. M., 29 vjeç, pasi ka kundërshtuar punonjësit e Policisë, gjatë veprimeve procedurale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Mallakastër referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin K. T., banues në fshatin Kapaj, Mallakastër, pasi ka pushtuar një sipërfaqe toke në pronësi të një shtetasi tjetër.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kolonjë arrestuan në flagrancë shtetasin E. Sh., 29 vjeç, banues në Ersekë, Kolonjë, pasi është kapur nga shërbimet e Policisë, jashtë banesës, nga e cila ka dalë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës, që i kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest në shtëpi", për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik".

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:

-D. N., 33 vjeç, banues në Korçë, pasi në lagjen nr.10, gjatë kontrollit fizik iu gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, një sasi e vogël lënde e dyshuar narkotike Cannabis Sativa;

-J. H., 33 vjeç, dhe E. K., 25 vjeçe, banues në Bilisht, Devoll, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", pasi në Bilisht, gjatë kontrollit iu gjetën një sasi e vogël lënde e dyshuar narkotike kokainë, një peshore elektronike, një cigare me përmbajtje lënde të dyshuar narkotike cannabis sativa dhe një shumë lekësh, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me dy celularë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin A. G., 35 vjeç, banues në Korçë, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj babait të tij, i cili u pajis me urdhër mbrojtjeje.

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori dhe u shpall në kërkim shtetasi V. Q., 68 vjeç, banues në Cerje, Pustec, pasi gjatë kontrollit në banesën e tij, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 4 krehra fishekësh dhe sasi municionesh luftarake, që i mbante pa leje. Po punohet për kapjen e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:

-K. Ç., 36 vjeç, banues në fshatin Proptisht, Pogradec, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes së tij, e cila u pajis me urdhër mbrojtjeje. Vijon puna për dokumentimin ligjor të rastit;

-Xh. B., 29 vjeç, banues në fshatin Memëlisht, Pogradec, pasi dyshohet se i ka vjedhur çantën e krahut, një 28-vjeçari, në një lavazh.